



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/114

Datë: 30.01.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4, paragrafi 1.7 dhe nenit 17 të ligjit nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën, nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2013, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Qendrës Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën me seli në Stamboll - Republika e Turqisë

1. Themelohet Qendra Kulturore e Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën me seli në Stamboll - Republika e Turqisë.
2. Qendra Kulturore nga pika 1. e këtij Vendimi do të funksionoj në pajtim me Ligjin Nr.04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Diasporës që të udhëheqë të gjitha procedurat për themelimin dhe funksionalizimin e Qendrës nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë